

Nga ky monitorim, D+ ka identifikuar një numër gjetjesh të cilat janë të përbashkëta për këto katër komuna, por gjithashtu janë evidentuar edhe shkelje të cilat janë karakteristikë e veçantë për secilën komunë. Disa prej gjetjeve kryesore të këtij raporti janë:

- Komuna e Graçanicës nuk ka llogaritur si duhet sigurinë e tenderit dhe atë të ekzekutimit të kontratës. Komuna ka paguar avans për një kompani, shuma e së cilës ka qenë më e lartë se siguria e ekzekutimit, duke vënë komunën në rrezik nëse kontrata nuk do të realizohej si duhet. Po ashtu, është përdorur kontrata kornizë për ndërtim dhe rikonstruim, përderisa ligji e lejon që të përdoret për riparime dhe mirëmbajtje në tenderët për ekzekutim të punëve.
- Komuna e Mamushës, ka paraparë kërkesa të panevojshme për tenderë të furnizimeve, siç është plani dinamik dhe kërkesa për referenca të kontratave të përfunduara. Këto sipas interpretimit të KRPP-së nuk duhet të kërkohen për tenderë që kanë të bëjnë me furnizime të produkteve që nuk prodhohen nga operatori ekonomik. Përveç tjerash, komuna vazhdon të pranojë katalogje të shkruara nga vetë kompanitë e që nuk mund të konsiderohen si katalogje zyrtare të prodhuesit.
- Komuna e Shtërpcës përmes kriterëve të dosjes së tenderit, shkurtimit të afatit për të ofertuar, ka bërë që të përshtaten kriteret vetëm për një ofertues të caktuar, i cili edhe e ka fituar kontratën. Në një tender tjetër komuna nuk ka verifikuar fare çmimet e dhëna nga operatori ekonomik. Në dy aktivitetet tjera komuna nuk ka përdorur njësinë e duhur matëse dhe ka përzier artikuj me një pozicion që kanë njësi matëse të ndryshme.
- Komuna e Novobërdës vazhdon të përdorë procedurën me poentim, gjë e cila mund të shkaktojë pasiguri te ofertuesit pasi nuk mund t'i dinë paraprakisht sasinë që do të porositen, ndërsa rreziku është që një operator ekonomik (OE) të ketë informata për sasinë që do të porositen dhe të japë kështu çmime shumë të larta në ato që porositen më shumë dhe më të ulëta në ato që porositen më pak. Në një aktivitet tjetër komuna nuk ka marrë parasysh çmimin e kontratës paraprake gjatë përcaktimit të vlerës së parashikuar.